



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 174 / 3 Prot.

Vlorë më, 27.06.2025

VENDIM

Nr. 67, datë 26.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR.64, DATË 20.12.2019
"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN,
RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE"
TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ligjit 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", Udhëzimit Nr. 46 datë 28.03.2017 për "Përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të sigurisë", në zbatim të ligjit nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", si dhe referuar shkresës nr.990/1, prot, datë 10.04.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 26.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në vendimin nr. 64, datë, 20.12.2019 "Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. ASOC. DENADA SOTA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

